

# DFF - Hua senior për Ujë Rugove

<b>Shteti:</b>	KOSOVË
<b>Projekti Nr.:</b>	53632
<b>Spektori i biznesit:</b>	Agrobiznes
<b>Lloji i Njoftimit:</b>	PRIVAT
<b>Kategoria Mjedisore:</b>	B
<b>Data e Synuar e Aprovimit:</b>	08 gusht 2023
<b>Statusi:</b>	Aprovuar
<b>DPP i shpalosur:</b>	17 gusht 2023

## Përshkrimi i projektit

Ofrimi i një huaje senior, afatgjatë dhe të lidhur me çështjet MSQ për Ujë Rugove për të mbështetur planin e tyre të investimeve në lidhje me: (i) blerjen dhe instalimin e linjave të reja dhe automatike të mbushjes për shishe qelqi, alumini, karton, fuçi dhe shurup; (ii) blerjen dhe rinovimin e objektit ngjitur për instalimin e linjave mbushëse të lartpërmendura, dhe (iii) kapitalin punues të lidhur.

## Objektivat e Projektit

Projekti do të mbështesë planin e investimeve të Ujë Rugove që do t'i mundësojë kompanisë të ndjekë strategjinë e vet të zgjerimit në drejtime të reja të tregut duke: (a) lansuar kategori të reja të produkteve - p.sh. ujë mineral me gaz, ujë me shije të shtuar dhe me infuzion (si natyral ashtu edhe me gaz), dhe çajra të ftohtë (me shije pjeshke dhe limoni); (b) zgjeruar prezencën e vet në treg dhe shitjet në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut; dhe (c) lansuar paketime të reja të kanaçeve dhe kartonit, si dhe paketime më efikas dhe modern të shisheve të qelqit dhe fuçive. Projekti dhe financimi përfshin edhe objektiva të lidhura me çështjet MSQ në lidhje me përmirësimin e raportit të shfrytëzimit të ujit, reduktimin e mbetjeve në prodhim prej ambalazheve të shisheve të qelqit dhe fuçive plastike, futjen e të paktën 50% të shiritave dhe etiketave të ricikluara në paketime, si dhe masa për mbështetjen e barazisë së mundësive.

## Ndikimi i Tranzicionit

ETI 80

**Konkurrues** është cilësia parësore e NT-së, pasi që projekti do të mbështesë planet e zgjerimit të Kompanisë siç përshkruhen në Objektivat e Projektit dhe konkurrueshmërinë e saj nëpërmjet futjes së kategorive të produkteve me vlerë më të lartë të shtuar dhe ekonomive të përmirësuara të shkallës.

**I gjelbër** është cilësia dytësore e NT-së, pasi që pjesa për TEGJ e projektit është 75% në lidhje me përmirësimet e qëndrueshmërisë që priten të rezultojnë nga objektivat dhe masat e tij të lidhura me MSQ siç përshkruhen në Objektivat e Projektit.

## Informata për Klientin

UJË RUGOVE SHPK

Ujë Rugove sh.p.k. ("Kompania") është një kompani NVM e themeluar dhe që operon në Kosovë prej vitit 2006. Është prodhuesi kryesor i ujit natyral në shishe në Kosovë.

## Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

6,000,000.00 EURO

Hua senior, afatgjatë dhe e lidhur me çështjet MSQ deri në 6.0 milionë euro që Kompanisë do t'i jepet në dy këste (Kësti 1 deri në 3.5 milionë euro dhe Kësti 2 deri në 2.5 milionë euro), të cilët të dy pritet të nënshkruhen në shtator 2023. Transaksioni parashikohet gjithashtu t'i ofrohet Fondit të Zgjerimit të Ndërmarrjeve II për Ballkanin Perëndimor ("ENEF II") për bashkëfinancim prej të paktën 50% të huasë.

## Gjithsej Kosto të Projektit

6,000,000.00 EURO

## Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategorizuar B (ESP 2019) dhe vlerësuar me risk të ulët-mesatar. Risqet mjedisore dhe sociale që lidhen me Projektin janë kryesisht specifike për lokacionin dhe mund të menaxhohen me masa të përshtatshme zbutëse. Shqyrtimi MS mbuloi një gamë të gjerë të temave duke përfshirë kapacitetin organizativ për menaxhimin MS, SHS në punë, sigurinë ushqimore, eficientë e resurseve, menaxhimin e kontraktorëve, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, SHS në komunitet, si dhe praktikat e punësimit. Për të adresuar çështjet e identifikuar MS, është zhvilluar një plan veprimi mjedisor dhe social (PVMS) dhe është dakorduar me Kompaninë. PVMS është i strukturuar për të siguruar pajtueshmërinë e Kompanisë me Kërkesat e Performancës së Bankës dhe përfshin masa për zbatimin e sistemeve të menaxhimit MS, zbatimin e mbikëqyrjes SHS të kontraktorëve të ndërtimit dhe furnizuesve. Kompanisë do t'i kërkohet të ofrojë raportim vjetor për performancën e saj për MS dhe zbatimin e PVMS-së.

## Bashkëpunimi Teknik

Konsulenca juridike për kujdesin e duhur dhe përgatitjen e dokumenteve financuese me kosto deri në 53,000 euro do të mbulohet 80% nga fondet për BT të lidhura me ENEF II dhe të vëna në dispozicion nga Fondi për Ndikim të Biznesit të Vogël nga një kontribut i Italisë dhe 20% nga kontributi i klientit.

## Shtueshmëria

- BERZH ofron dhe mobilizon financime që nuk janë të disponueshme në treg nga burime komerciale me terma dhe kushte të arsyeshme, siç janë shuma më e madhe dhe afati më i gjatë i huasë së BERZH-it që kërkohen për strukturimin e projektit.
- Klienti kërkon / përdor ekspertizën e BERZH-it për standarde më të larta mjedisore dhe sociale (mbi "biznes si zakonisht") në lidhje me TKP-të e lidhura me çështjet MSQ dhe që synojnë përmirësimin e raportit të shfrytëzimit të ujit, reduktimin e mbetjeve në prodhim prej shisheve të qelqit dhe fuçive plastike, arritjen e të paktën 50% të shiritave dhe etiketave të ricikluara në paketim, miratimin e politikës dhe objektivave gjinore dhe për mundësi të barabarta.

## Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Visar Kelmendi  
[info@rugove.eu](mailto:info@rugove.eu)  
+38338560462  
[www.rugove.eu](http://www.rugove.eu)

## Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

## Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrënë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt. OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime për praktikën mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdo gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

## Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo

Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.